

Dr. A.S. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

Të Nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Gjatë disa muajve të fundit, shumë individë në të gjithë qytetin kanë qenë të zënë duke kontribuar në zhvillimin e një Plani Strategjik 5-vjeçar. Ndërsa kanë mbetur ende disa etapa, doja të festoja përfundimin e dy momenteve kryesore: rishikimin e misionit, vizionit dhe vlerave thelbësore të Drejtorisë dhe krijimin e një teorie veprimi në të gjithë Drejtorinë.

Bordi i Arsimit rishikoi misionin, vizionin dhe vlerat bazë duke përdorur reagimet nga të gjitha ekipet e Planit Strategjik dhe rezultatet nga anketa publike. Falenderoj ata prej jush që gjetën kohë për të plotësuar anketën dhe për të ndarë njohuritë tuaja. Versionet e përditësuara mund të shihen në: [Websajtin e "District's strategic planning"](#).

Për të adresuar nevojën për një teori të qartë, të komunikuar mirë të veprimit, siç është përshkruar nga [Raporti i Grupit të Tranzicionit](#), ne kemi punuar në bashkëpunim me Komitetin Drejtues, Ekipin Udhëheqës dhe Grupet Këshillimore për të zhvilluar këtë teori veprimi që është një deklaratë e nivelit të lartë se si ne planifikojmë të përmirësojmë, të përshpejtojmë përparimin drejt qëllimeve tona dhe t'i ndihmojmë studentët të përgatiten për çdo të ardhme që ata imagjinojnë:

Teoria e Veprimit

Kur përqëndrohemi në...

- Angazhimin me familjet dhe anëtarët e komunitetit në edukimin e të gjithë nxënësve;
- Duke i dhënë përparësi mirëqenies social-emocionale, shëndetit mendor dhe sigurisë intelektuale dhe fizike të të gjithë studentëve dhe personelit ;
- Përqëndrimi i shkollave dhe ekipeve drejtuese të shkollave si njësi ndryshimi;
- Avancimi i barazisë përmes gjithçkaje që bëjmë dhe çdo vendimi që marrim; dhe
- Përafrimi i burimeve, trajnimeve dhe strukturave tona të llogaridhënies me një numër të kufizuar prioritesh inovative dhe të bazuara në kërkime

Më pas do të arrijmë Objektivat dhe Qëllimet dhe do të transformojmë të mësuarin dhe rezultatet e jetës për të gjithë studentët.

Dua të theksoj se publikimi i këtij plani më 25 Maj 2023, Plani ynë Strategjik, do të jetë një moment historik i rëndësishëm për Drejtorinë. Do të jetë kulmi i bashkëpunimit prej muajsh. Faleminderit për pjesëmarrjen në turnetë e dëgjimit dhe mësimit, Ekipit të Tranzicionit dhe Grupeve Këshillimore të Planit Strategjik – kontributi juaj do të informojë drejtpërdrejt drejtimin e Drejtorisë për pesë vitet e ardhshme. Ju lutemi vazhdoni të vizitoni ["District's strategic planning website"](#) për përditësime ndërsa vazhdojmë këtë proces.

Në partneritet,

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias